



**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 89, datë 31.05.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL”
SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4, pika 11, 12, 50; nenit 22, pika 2, gërma “c”; nenit 75 pika 1, të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “c”; nenit 5; nenit 8, nenit 9 pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, “d,” “ e”; pika 2, gërma “f”; dhe nenit 10, pika 1, të “Rregullave dhe Procedurave për licensimin, ndryshimin, transferimin e pjesëshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE- nr.97, datë 04.07.2019 nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, lidhur me fillimin e procedurave për Licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sha, në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 348 Prot, datë 16.05.2019, shoqëria “ALBPETROL” sha, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të aplikimit të shoqërisë “ALBPETROL” sha në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, rezulton se:
- Neni 9, pika 1 “Format dhe Dokumentacioni për Aplikim”:
 - gërma “a” “b” “c”, janë Plotësuar.
 - gërma “d” “Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor”,
 - pikat:
 - i. është plotësuar.
 - ii. është e pa plotësuar.
 - iii. Pa plotësuar.
 - vi është e pa plotësuar.
 - Gërma “e”. Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale,
 - pikat:
 - i. është e pa plotësuar.
 - ii. është e plotësuar pjesërisht
 - iii. është i pa plotësuar.

- iv. është e pa plotësuar.
- v. është e pa plotësuar.
- Neni 9, pika 2 “dokumente specifike për llojin e licencës”
Gërma “f”, pikat:
 - i. është e pa plotësuar
 - ii. është plotësuar
 - iii. është plotësuar

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transmetimit të plotë/të pjeshëm dhe rinovimit të licencave për sektorin e gazit natyror*”, t’i paraqesë në ERE, këto dokumenta brenda afatit të caktuar.

- Neni 23, pika 1, gërma “a” e ligjit nr.102/2015 “*Për Sektorin e Gazit Natyror*”, i ndryshuar, parashikon se : ERE përcakton afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili, për veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes, të depozitimit dhe të GNL-së, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet dhe për veprimtaritë e tjera nuk mund të jetë më shumë se 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje;

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror, për një afat 10 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI